

URDHËR
Nr. 243, datë 8.6.2021

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË
MJEDISET E HAPURA DHE TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

(ndryshuar me urdhrin nr. 262, datë 21.6.2021)

(i përditësuar)

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, germa “b”, e nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtisë së shpendëve të gjallë në mjediset e hapura, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. *Lejimin e tregtimit të shpendëve të gjalla, nga fermat në zonat e lira nga influenza aviare, në treg, të shoqëruara me raport-analizë (PCR) lëshuar nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, që vërteton që shpendët janë të pastër nga Influenca Aviare dhe certifikatë shëndetësore veterinarë lëshuar nga veterineri zyrtar.*

3. *Lejimin e tregtimit nga ferma në fermë të shpendëve, ferma në zonat e lira, shoqëruar me certifikatë shëndetësore veterinarë, lëshuar nga veterineri zyrtar përkatës.*

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Milva Ekonomi